



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 12/08/2021 Ref.: 3032/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimit të Kolegjit të Shkencave Mjekësore “Rezonanca”, për periudhën tri (3) vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Asistent Dentar dhe Higjienist Dentar, BSc, 240 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik,
 - Shëndeti Publik dhe Mjedisor, BSc, 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik,
- II. Akreditohet programi i studimit të Kolegjit të Shkencave Mjekësore “Rezonanca”, për periudhën dy (2) vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2023:
 - Menaxhment Shëndetësor, MSc, 120 ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik.
- III. Nuk akreditohen programet e studimit të Kolegjit të Shkencave Mjekësore “Rezonanca”:
 - Teknik i Lartë i Anestezisë dhe Kujdesit Intensiv, BSc, 180 ECTS.
 - Psikologji Klinike, BSc, 180 ECTS.
- IV. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- V. Obligohet Kolegji i Shkencave Mjekësore “Rezonanca” që deri më datë 15.11.2021 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Kolegji i Shkencave Mjekësore “Rezonanca” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1	Asistent Dentar dhe Higjienist Dentar, BSc, 240 ECTS Akreditim	Vlorë Cakolli Ngadhnjim Domi Jeta Kelmendi Granita Cena
2	Shëndeti Publik dhe Mjedor, BSc, 180 ECTS Akreditim	Raif Bytyçi Luan Daija Ardita Sylejmani
3	Menaxhment Shëndetësor, MSc, 120 ECTS Akreditim	Mimoza Maksutaj Fitim Skeraj Milazim Gjocaj Valdet Hashani
4	Teknik i Lartë i Anestezisë dhe Kujdesit Intensiv, BSc, 180 ECTS Akreditim	Qamile Morina Xhevdet Çuni Basri Lenjani Bedri Braha Valon Zejnullahu
5	Psikologji Klinike, BSc, 180 ECTS Akreditim	Naim Fanaj Ramadan Halimi Kamber Zeqiraj

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin e Shkencave Mjekësore “Rezonanca”, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizita është organizuar më 11.05.2021, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Adrian Stan, Helvi Kyngas, Melita Kovacevic, Sanja Kalambura, Wolfgang Patsch, Delia Gologan.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit Asistent Dentar dhe Higjienist Dentar, BSc, 240 ECTS, - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë substancialisht pesë (5) dhe pjesërisht dy (2).
2. Për programin e studimit Shëndeti Publik dhe Mjedor, BSc, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë substancialisht pesë (5) dhe pjesërisht dy (2).
3. Për programin e studimit Menaxhment Shëndetësor, MSc, 120 ECTS, - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë substancialisht katër (4) dhe pjesërisht tri (3).
4. Për programin e studimit Teknik i Lartë i Anestezisë dhe Kujdesit Intensiv, BSc, 180 ECTS, - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë substancialisht dy (2) dhe pjesërisht pesë (5).


5. Për programin e studimit Psikologji Klinike, BSc, 180 ECTS, - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë substancialisht një (1) dhe pjesërisht gjashtë (6).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07 dhe 27 korrik 2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca";
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

